



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

101/9
Nr.Prot.

Tiranë, më 30.12.2013



MIRATOHET

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

PROGRAMET E ARSIMIT BAZË

(Për klasat e shansit të dytë)

LËNDA: HISTORI

KLASA VI-IX

Tiranë

Dhjetor 2013

I. TË PËRGJITHSHME

Historia, si një shkencë humane, është thelbësore në zhvillimin e qytetarëve, të cilët i kuptojnë çështjet aktuale me zgjuarsinë dhe me mprehtësinë e fituar nga përvojat e së shkuarës.

Detyra e programit të historisë është të drejtojnë nxënësit për t'u bërë pjesëtarë të përgjegjshëm të shoqërisë, të cilët dinë si të trajtojnë në mënyrë kritike një fenomen të epokës së tyre dhe të së shkuarës. Nëpërmjet programit të historisë, nxënësit kuptojnë se kulturat e tyre dhe kulturat e tjerapërbëjnë rezultatin e një procesi historik. Një kuptim i thellë dhe i gjerë i historisë, pasuron përvojën personale të nxënësve, pasi i mëson ata të luajnë rolin e tyre në jetë dhe në shoqëri, si ruajtës të parimeve të një shoqërie demokratike, si trashëgimtarë të shumë kulturave dhe si anëtarë të një bote ekonomike të ndërvarur dhe me kultura të ndryshme që jetojnë në harmoni, duke respektuar identitetin e njëra-tjetrës.

Lënda e historisë për klasat e shansit të dytë, në arsimin e mesëm të ulët do të zhvillohet nga klasa e gjashtë deri në klasën e nëntë me një orë në javë, gjithsej 30 orë vjetore për secilën klasë, sipas planit mësimor të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit.

Ky program trajton ngjarjet historike në vazhdimësi kronologjike, e cila mundëson lidhjen e brendshme e të jashtme midis periudhave dhe shoqërive të ndryshme, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimin botëror. Ai synon që të krijojë te nxënësi bindjen se qytetërimi i sotëm është një vazhdimësi progresive e qytetërimit të hershëm, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Ruajtja e kronologjisë zbaton kriterin shkencor të zhvillimit të ngjarjeve mbi lidhjen shkak-pasojë dhe vazhdimësinë progresive të rrjedhës historike.

Trajtesa tematike shpreh natyrën përzgjedhëse të programit, i cili nuk ka si qëllim të mbulojë të gjitha ngjarjet e historisë, gjë që do të sillte një ngarkesë të panevojshme për nxënësin, por të trajtojë problemet thelbësore, modelet historike që përbëjnë rrënjët e qytetërimit të sotëm. Trajtesa tematike ka pasur parasysh edhe vendosjen e një baraspeshe historike mes kontributeve të krijuara në periudha të ndryshme në lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve pasardhëse, duke shprehur vlerat e tyre në një këndvështrim të barabartë.

1. SYNIME TË LËNDËS

Programet e historisë për klasat 6-9 synojnë:

- të aftësojnë nxënësit për t'u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në dimensionet lokale, kombëtare, rajonale, evropiane e globale, duke u mundësuar atyre të ndërtojnë identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë së tyre historike të përbashkët;
- të aftësojnë nxënësit për të ndërvepruar me individë dhe grupe individësh të kulturave të ndryshme, për të njohur të kaluarën dhe për të kuptuar ndërveprimin e saj me të sotmen, duke nxënë, analizuar dhe menduar në mënyrë kritike;
- të edukojnë nxënësit me ndenjën e mirëkuptimit dhe të besimit të ndërsjellë midis popujve, nëpërmjet studimit të kulturës, të shkëmbimeve të shumanshme dhe të trashëgimisë;
- të zhvillojnë aftësitë intelektuale të nxënësit për të analizuar dhe për të interpretuar informacionin historik në mënyrë kritike dhe të përgjegjshme, nëpërmjet dialogut, kërkimit të së vërtetës dhe përmes debatit të hapur, sidomos për çështjet e ndjeshme historike;
- të përshkruajnë momentet më kulmore të zhvillimit të shoqërisë, nëpërmjet një trajtimi kronologjik tematik;
- të vlerësojnë pozitën e qytetërimit shqiptar brenda qytetërimit botëror;
- të zhvillojnë aftësitë e të kuptuarit të historisë së vendit, të Evropës dhe të botës;
- të bëhen të vetëdijshëm për interpretimet e ndryshme të çështjeve të veçanta historike.
- të zhvillojnë aftësitë bazë të kërkimit historik;
- të vlerësojnë natyrën dhe larminë e provave historike;
- të interpretojnë shoqërinë njerëzore në të kaluarën, në mënyrë që nxënësit të kuptojnë të sotmen dhe ndikimin e tyre në zhvillimet historike të së ardhmes;
- të interpretojnë efektin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në marrëdhëniet historike dhe rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes;
- të argumentojnë vlerat e trashëgimisë historike, duke e vlerësuar këtë trashëgimi si pjesë të përcaktimit të identitetit të një populli;
- të forcojnë ndjenjën e identitetit kombëtar dhe të respektit për historinë kombëtare, me qëllim zgjerimin e përmasave evropiane në studimin e historisë;
- të krijojnë mundësi për punë kërkimore, duke u bazuar në burime historike, për studimin e ngjarjeve të ndryshme të historisë;

- të zhvillojnë, përmes studimit të historisë, aftësitë qytetare, të cilat kontribuojnë në rritjen e tyre personale si individë, në përgatitjen e tyre në jetë, në punë dhe në shoqëri.

2. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Përmbajtja e kurrikulës së historisë për klasat 6-9 është organizuar si më poshtë:

Në **klasën e 6-të**, përmbajtja e lëndës “Qytetërimet e hershme dhe mesjetare botërore”, përfshin studimin e zhvillimeve më të rëndësishme të historisë së lashtë dhe mesjetës. Programi do të përshkruajë kushtet, etapat, tiparet ekonomike, shoqërore, politike, kulturore, materiale e shpirtërore të zhvillimit të qytetërimeve antike dhe mesjetare. Nëpërmjet tij nxënësit kuptojnë kalimin nga qytetërimet në lashtësi në qytetërimet mesjetare, duke dalluar lidhjen ndërmjet këtyre qytetërimeve dhe vlerat e tyre në qytetërimet e sotme.

Në **klasën e 7-të**, përmbajtja e lëndës “Njohuri themelore për historinë moderne botërore” (shek. XVI – fundi i shek. XIX) trajton zhvillimet më të rëndësishme të shoqërisë njerëzore që nga Rilindja e vonë Evropiane deri në fund të shekullit XIX.

Programi përshkruan evoluimin e qytetërimit evropian nga periudha e mesjetës në atë moderne, duke evidentuar frymën e re që ai merr me zbulimet e mëdha gjeografike dhe me lëvizjet e mëdha kulturore, fetare e politike, që përfshinë Evropën pas shekullit XV deri në fillim të shekullit XX. Ai prezanton kthesën e madhe që mori qytetërimi botëror pas Rilindjes Evropiane. Përmes tij, nxënësit kuptojnë ndryshimet rrënjësore në jetën ekonomike, politike, shoqërore, humane, kulturore, shkencore dhe fetare, të cilat çuan në lindjen e botës moderne dhe patën ndikim në arritjet e qytetërimit bashkëkohor. Programi i klasës së 7-të pasqyron ndryshimet rrënjësore, që shkaktuan revolucionet politike, industriale dhe ideologjike në qytetërimin perëndimor dhe atë botëror. Ai përfshin lindjen e nacionalizmit, i cili çoi në krijimin e shteteve nacionale në Evropën Qendrore dhe në Ballkan. Gjithashtu, ai trajton edhe fillimet e liberalizmit në jetën politike dhe ekonomike, që i siguroi qytetarit të drejtat sociale dhe politike.

Në **klasën e 8-të**, lënda “Njohuri për historinë botërore të shekullit XX” trajton tronditjet dhe krizat që çuan në fillimin e luftërave botërore. Nëpërmjet këtij programi, nxënësit kuptojnë dhe gjejnë për shkaqet dhe pasojat e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore në jetën ekonomike, politike dhe shoqërore të qytetërimit botëror. Nxënësit mësojnë mbi përpjekjet e bëra për kapërcimin e krizave, veçanërisht atyre ekonomike, si dhe krijojnë bindjen se çdo konflikt rajonal, ose me shtrirje më të gjerë, sjell kosto negative për të ardhmen e shoqërisë. Programi i

klasës së 8-të krijon një tablo të qartë për drejtimit e ndryshme në fushën e artit, kulturës dhe mënyrave të jetesës në shoqërinë e dy sistemeve (demokratike dhe totalitare).

Programi ka për qëllim t'i njohë nxënësit me shkaqet e fillimit të Luftës së Ftohtë, arsyen e ndarjes së botës në dy blloqe dhe pasojat e saj në zhvillimet politike, ekonomike e shoqërore. Ai do të përshkruajë ecurinë e zhvillimeve të mëvonshme ekonomike, të njohura si “mrekullia ekonomike” ose “vitet e arta” ,gjatë së cilës u realizua kalimi në shoqërinë postindustriale dhe triumfoi shteti i mirëqenies sociale. Nxënësit do të prezantohen dhe meprirjet e qytetërimeve të sotme, sindryshime në strukturën sociale dhe zhvillimin e klasës së mesme, rritjen e rolit të gruas në qeverisje; globalizmin, uniformitetin, zhvillimin e shkencës, teknologjisë, kulturës, artit dhe arsimit, për të evidentuar prirjen dhe perspektivën e qytetërimeve të sotme.

Në **klasën e 9-të**, nëprogramin e lëndës “Njohuri mbi historinë e popullit shqiptar” trajtohet historia e shqiptarëve nga periudha parahistorike deri në ditët tona. Programi i klasës së 9-të ka për qëllim ta njohë nxënësin me rrënjët historike të vendit. Nëpërmjet tij, nxënësi do të kuptojë ligjësitë themelore të organizimit, të funksionimit dhe të zhvillimit të shoqërisë shqiptare; do të analizojë ngjarjet dhe personalitetet që i dhanë tiparet kryesore, përshpejtuan dhe thelluan proceset politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore në periudha të ndryshme historike të popullit shqiptar; do të vlerësojë ndikimin e ndërsjellë të kulturave dhe të ngjarjeve historike të popullit shqiptar me ato të popujve të tjerë rajonalë dhe më tej.

3. LINJAT E PROGRAMIT

Të ndara sipas klasave, linjat dhe orët e sugjeruara jepen të përmbledhura në tabelat e mëposhtme.

Në **klasën VI**, lënda “Qytetërimet e hershme dhe mesjetare botërore” do të zhvillohet në 30 javë mësimore me 1 orë në javë.

30 javë x 1 orë / javë = 30 orë

NR.	LINJAT	Sasia e orëve
1.	Parahistoria	1 orë
2.	Qytetërimet e lumenjve	1 orë
3.	Greqia e lashtë	3 orë
4.	Maqedonia e lashtë	1 orë
5.	Roma e lashtë	3 orë

6.	Ilirët	3 orë
7.	Mesjeta e hershme (476-1000)	3 orë
8.	Organizimi shoqëror në mesjetë	2 orë
9.	Krijimi i monarkive kombëtare	2 orë
10.	Perandoria osmane	1 orë
11.	Arbëria në shekujt XI-XV	2 orë
12.	Humanizmi dhe rilindja evropiane	2 orë
Përsëritje, teste, punë praktike, ekskursione		6 orë

Në klasën VII, lënda “Njohuri themelore për historinë moderne botërore” do të zhvillohet në 30 javë mësimore me 1 orë në javë.

30 javë x 1 orë / javë = 30 orë

NR.	LINJAT	Sasia e orëve
1.	Shoqëria evropiane në fillimet e kohës moderne	3 orë
2.	Konsolidimi i monarkive absolute evropiane.	2 orë
3.	Ndryshimet në jetën ekonomike e shoqërore në shekujt XVII - XVIII	1 orë
4.	Idetë e reja dhe kombet e reja	4 orë
5.	Evropa në vitet 1815-1850	3 orë
6.	Nacionalizmi dhe realizmi. 1850-1871	3 orë
7.	Perandoria osmane dhe Ballkani në shek. XVI-XIX	3 orë
8.	Fillimet e qeverisjes së demokracisë liberale 1871-1900	6 orë
9.	Qytetërimi në pragun e shekullit XIX	1 orë
Përsëritje, teste		4 orë

Në klasën VIII, lënda “Njohuri për historinë botërore të shekullit XX” do të zhvillohet në 30 javë mësimore me 1 orë në javë.

30 javë x 1 orë / javë = 30 orë

NR.	LINJAT	SASIA E ORËVE
1.	Bota në fillim të shekullit XX. Lufta e Parë Botërore	2 orë

2.	Traktatet e paqes dhe problemet e pazgjidhura të pas luftës	1 orë
3.	Diktaturat. Totalitarizmi komunist e fashist	2 orë
4.	Demokracitë perëndimore në vitet 1918-1939	3 orë
5.	Vendet e Ballkanit në vitet 1918-1939	2 orë
6.	Lufta e dytë botërore. Ndarja e botës në dy blloqe.	4 orë
7.	Konsolidimi i demokracisë dhe zhvillimi ekonomik i Evropës Perëndimore dhe i ShBA-ve 1945-1990	3 orë
8.	Blloku komunist. Dështimi i komunizmit 1945-1990	2 orë
9.	Vendet e Ballkanit në vitet 1945-1990	2 orë
10.	Shkenca, kultura, arti dhe problemet e botës së sotme	2 orë
Përsëritje, teste, punë praktike, ekskursione		7 orë

Në klasën IX, lënda “Njohuri mbi historinë e popullit shqiptar” do të zhvillohet në 30 javë mësimore me 1 orë në javë.

30 javë x 1 orë / javë = 30 orë

NR.	LINJAT	Sasia e orëve
1.	Paraardhësit e Shqiptarëve	1 orë
2.	Shtetet Ilire	1 orë
3.	Shqipëria mesjetare shek V – XIV	2 orë
4.	Epoka e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut	3 orë
5.	Shqipëria gjatë sundimit osman(shek. XVI-XIX)	3 orë
6.	Rilindja kombëtare shqiptare(vitet 30 deri 1908)	3 orë
7.	Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë 1908-1912	2 orë
8.	Shqipëria dhe viset e tjera shqiptare jashtë kufijve në vitet 1912-1939	3 orë
9.	Shqipëria në vitet 1925-1928	2 orë
10.	Gjendja e shqiptarëve etnike në Jugosllavi dhe Greqi 1925-1940	1 orë
11.	Shqiptarët gjatë Luftës II Botërore	2 orë
12.	Shqipëria gjatë regjimit komunist	3 orë

13.	Rënia e regjimit komunist	2 orë
14.	Shqiptarët jashtë kufijve politikë	2 orë

4. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Programet e historisë për klasat 6-9, zbatohen në 120 orë mësimore, nga 30 orë për çdo klasë.

Linjat e programit zbërthehen në tematika përkatëse dhe objektiva. Objektivat përcaktojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që duhet të fitojë çdo nxënës në fund të secilës klasë. Të gjithë nxënësve duhet t'u jepen mundësi të barabarta për të arritur objektivat në fjalë. Objektivat e të nxënët grupohen në objektiva:

- tënjohurive,ku nxënësit marrin njohuritë dhe mësojnë konceptet kryesore të lëndës së historisë dhe i përdorin ato në kontekste e situata të ndryshme;
- tëaftësive,ku nxënësit zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të menduar në mënyrë kritike, për të kryer punë kërkimore, për të organizuar, interpretuar dhe komunikuar informacionin e përftuar, për të zgjidhur probleme të ndryshme, për të menduar në mënyrë krijuese, për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në grup, për të marrë vendime të mirinformuara;
- tëqëndrimeve,ku nxënësit nxiten të formojnë dhe të mbajnë qëndrime individuale dhe në grup, bazuar në argumente, vlera dhe besime të përftuara gjatë edukimit, për të mirën e përbashkët të shoqërisë.

5. METODAT E MESIMDHËNIES

Përdorimi i një numri të larmishëm metodash në mësimin e historisë nga mësuesit është një përbërës thelbësor në procesin e zbatimit me sukses të kurrikulës së historisë.

Metodat dhe teknikat e të mësuarit shikohen jo vetëm si një proces didaktik, që pasurohen gjithnjë me elemente të reja, por edhe që duhet të zbatohen në mënyrë krijuese. Gjatë orëve të ndryshme të mësimin, metodat e teknikat ndërthuren me njëra-tjetrën, aq sa shpesh nuk mund t'i dallosh kufijtë midis tyre. Kështu ndodh me shpjegimin e bisedën, me metodën problemore e kërkimore, stuhia e mendimit, harta e mendimit, loja dhe konkursi etj. Prandaj, vëmendja e veçantë e mësuesit duhet drejtuar te lidhja organike e metodave dhe e teknikave të veçanta që ai përdor brenda një ore mësimi.

Format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit, duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjen lëndore, por edhe me nivelin e nxënësve, gjendjen e bazës didaktike etj.

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga vetë mësuesi në përshtatje me veçoritë e temave të ndryshme mësimore. Një harmonizim i drejtë i këtyre metodave lehtëson realizimin e objektivave të lëndës, të parashikuara nga programi mësimor.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies që mund të zbatohen gjatë një ore mësimi, janë të shumta. Si të tilla mund të përdoret:

Shpjegimi, i cili mund të jetë i suksesshëm në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve që synojnë të kuptuarit e njohurive për zhvillimin në kohë e në hapësirë të dukurive dhe të proceseve historike;

Mësimi zbulues nëpërmjet të cilit kalohet nga njohuritë elementare në përgjithësime, nga hipotezat në gjetjen e origjinës së dukurive, nga problemet e thjeshta në zgjidhjen e tyre;

Biseda, e cila do të ishte më e efektshme për ato tema ku nxënësit kanë njohuri paraprake të bollshme që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv;

Diskutimi është një nga metodat më të thjeshta që përdoret në realizimin e veprimtarive në klasë, kur është fjala për të mundësuar procesin e pjesëmarrjes sa më të gjerë të nxënësve në mësim. Diskutimi është një përzierje e shpjegimeve mësues-nxënës, e shkëmbimit të pikëpamjeve dhe pyetjeve ndërmjet tyre. Diskutimi me të gjithë klasën është një mënyrë shumë e mirë për mësuesin dhe për nxënësit për të zbuluar se cilat janë qëndrimet e tyre rreth çështjeve, ngjarjeve dhe koncepteve të ndryshme që trajtohen në lëndën e historisë. Gjithashtu, diskutimi është një rast shumë i mirë për të praktikuar të dëgjuarit të nxënësit, të folurën me radhë dhe aftësi të tjera që nevojiten në punën në grup.

Mjaft rezultate janë edhe metodat që përfshihen në spektrin e metodave problemore, si: mësimi zbulues, veprimtari të praktike, ekskursionet, projekti mësimor etj. Këto metoda mund të përdoren në ato raste kur nxënësit, në mënyrë individuale ose të organizuar në grupe, ndërmarrin, me ndihmën dhe drejtimin e mësuesit, veprimtari që synojnë zgjidhjen e problemeve të thjeshta etj.

Veprimtari të praktike dhe projektet kurrikulare janë modele të veprimtarisë mësimore, realizimi i të cilëve kërkon zbatimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: kërkimi, intervista, vrojtimi,

studimi i rastit, ndërthurjen e të gjitha këtyre teknikave së bashku. Këto metoda e vënë theksin te aftësitë dhe te shprehitë.

Mjetet mësimore

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe në procesin e të nxënës në lëndën e historisë, ndihmon në konkretizimin e ideve dhe të dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bëjnë mësimin më interesant dhe më rezultativ për nxënësit. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat janë të llojeve të ndryshme, si: harta historike të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projeksioni, CD, DVD etj. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë ngjarjesh historike.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Objektiv i vlerësimit, nuk janë vetëm njohuritë dhe shprehitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale, në përgjithësi, edhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësuesi vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësit, aftësitë e tyre për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrim vetjak ndaj një ngjarjeje ose figure të caktuar historike.

Mësuesi i historisë duhet të vlerësojë përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme në histori. Kriter vlerësimi për nxënësit në lëndën e historisë është edhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të njëri-tjetrit, të bazuara mbi argumente ose fakte historike.

Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij me gojë, me shkrim ose nëpërmjet veprimtarive dhe produkteve të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, prodhimi i një CD-je, hartimi i një maketi për një ngjarje ose figurë të caktuar historike, projekte etj.

Në punimet e nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënë në veçanti.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë për parashtrimet me shkrim në testimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon teste periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një ose disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet pak minutëshe për një objektiv të veçantë të të nxënësve, tek ato një- orëshe; teste me alternativa ose me zhvillim; detyra tematike etj.

Dosja e nxënësve, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ajo mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare, tabelë kronologjike të ngjarjeve ose të një periudhe historike, CD, dokumentar mbi një ngjarje historike, biografi për histori gojore, postera, albume etj.

II. OBJEKTIVAT DHE TEMATIKAT SIPAS LINJAVE

KLASA VI
QYTETËRIMET E HERSHME DHE
MESJETARE BOTËRORE
30 javë x 1 orë = 30 orë

LINJAI

PARAHISTORIA

Tematika

1. Lindja dhe zhvillimi i njeriut. Paleoliti dhe neoliti.

KOHA: 1 ORË

LINJA2

QYTETËRIMET E LUMENJVE

Tematika

1. Egjiptianët e lashtë.

KOHA: 1 ORË

LINJA3

GREQIA E LASHTË

Tematika

1. Lindja e qytetërimit helen.
2. Athina dhe Sparta.
3. Besimi dhe kultura e grekëve të lashtë.

KOHA: 3 ORË

LINJA 4

MAQEDONIA E LASHTË

Tematika

1. Aleksandri i Madh i Maqedonisë krijon shtetin më të madh në botë.

KOHA: 1 ORË

LINJA 5

ROMA E LASHTË

Tematika

1. Themelimi i Romës.Shndërrimi i Romës në një shtet të fuqishëm mesdhetar.
2. Rënia e Republikës Romake dhe krijimi i Perandorisë Romake.
3. Lindja dhe përhapja e krishterimit.Kultura romake.

KOHA: 3 ORË

LINJA 6

ILIRËT

Tematika

1. Mbretëria dardane.
2. Shteti i Epirit.
3. Mbretëritë ilire. Arti dhe kultura ilire.

KOHA: 3 ORË

LINJA 7

MESJETA E HERSHME (476-1000)

Tematika

1. Dyndjet e popujve në Evropë.
2. Perandoria Romake e Lindjes, Bizanti.
3. Krijimi i Kalifatit Arab.Lindja dhe përhapja e islamizmit.

KOHA: 3 ORË

LINJA 8

ORGANIZIMI SHOQËROR NË MESJETË

Tematika

1. Feudalizmi.Lindja dhe zhvillimi i qyteteve.
2. Forcimi i ndikimit të kishës në shoqëri. Kryqëzatat.

KOHA: 2 ORË

LINJA 9

KRIJIMI I MONARKIVE KOMBËTARE

Tematika

1. Mbretëria angleze.

2. Mbretëria franceze.

KOHA : 2 ORË

LINJA 10

PERANDORIA OSMANE

Tematika

1. Perandoria osmane

KOHA: 10RË

LINJA 11

ARBËRIA NË SHEKUJT XI-XV

Tematika

1. Principata e Arbërisë, shteti i parë feudal shqiptar.
2. Principatat shqiptare.Kultura dhe arti në shekujt XIII-XV.

KOHA: 2 ORË

LINJA 12

HUMANIZMI DHE RILINDJA EVROPIANE

Tematika

1. Rilindja evropiane. Humanizmi.
2. Përhapja e Rilindjes në vende të tjera evropiane.

KOHA: 2 ORË

KLASA VII
NJOHURI THEMELORE PËR
HISTORINË MODERNE BOTËRORE
30 javë x 1 orë = 30 orë

LINJA 1

SHOQËRIA EVROPIANE NË FILLIMET E KOHËS MODERNE

Tematika

1. Rilindja e vonë evropiane dhe Protestantizmi.
2. Reformacioni katolik.

3. Zbulimet e mëdha gjeografike.

KOHA: 3 ORË

LINJA 2

KONSOLIDIMI I MONARKIVE ABSOLUTE EVROPIANE.

Tematika

1. Franca gjatë sundimit të Luigjit XIV.
2. Anglia, një fuqi tregtare dhe monarki kushtetuese.

KOHA: 2 ORË

LINJA 3

NDRYSHIMET NË JETËN EKONOMIKE E SHOQËRORE NË SHEKUJT XVII - XVIII

Tematika

1. Revolucioni i parë industrial, ndryshimet që ai solli në shoqëri.

KOHA : 1 ORË

LINJA 4

IDETË E REJA DHE KOMBET E REJA

Tematika

1. Iluminizmi.
2. Krijimi i ShBA-së.
3. Revolucioni francez. Përmbysja e regjimit absolut.
4. Napoleon Bonaparti. Fundi i Perandorisë së Napoleonit

KOHA: 4 ORË

LINJA 5

EVROPA NË VITET 1815-1850

Tematika

1. Kongresi i Vjenës.
2. Zhvillimet ekonomike kulturore e shkencore.
3. Revolucionet borgjeze të viteve 1830 në Evropë. Revolucionet e vitit 1848.

KOHA: 3 ORË

LINJA 6

NACIONALIZMI DHE REALIZMI 1850-1871

Tematika

1. Nacionalizmi dhe realizmi.
2. Bashkimi i Gjermanisë dhe bashkimi i Italisë.
3. Lufta Civile në ShBA.

KOHA: 3 ORË

LINJA 7

PERANDORIA OSMANE DHE BALLKANI NË SHEK. XVI-XIX

Tematika

1. Perandoria osmane dhe lëvizjet përparimtare në Perandorinë osmane.
2. Formimi i shteteve të pavarura në Ballkan.
3. Përpjekjet për krijimin e shtetit autonom shqiptar.

KOHA: 3 ORË

LINJA 8

FILLIMET E QEVERISJES SË DEMOKRACISË LIBERALE 1871-1900

Tematika

1. Revolucioni i dytë industrial. Rritja e qyteteve dhe problemet sociale.
2. Zhvillimet politike në Britaninë e Madhe.
3. Zhvillimet politike në Francë.
4. Gjermania.
5. Demokratizimi i mëtejshëm i ShBA-së.
6. Perandoria Ruse.

KOHA: 6 ORË

LINJA 9

QYTETËRIMI NË PRAGUN E SHEKULLIT XIX

Tematika

1. Imperializmi dhe nacionalizmi i skajshëm kërcënojnë stabilitetin.

KOHA: 1 ORË

KLASA VIII
NJOHURI PËR HISTORINË
BOTËRORE TË SHEKULLIT XX
30 javë x 1 orë = 30 orë

LINJA 1

BOTA NË FILLIM TË SHEKULLIT XX . LUFTA E PARË BOTËRORE

Tematika

1. Fuqitë botërore në një baraspeshë të vështirë.Lëvizjet qytetare dhe punëtore.
2. Lufta e Parë Botërore. Rrjedhojat e Luftës.

Objektiva

Nxënësit duhet :

- të rendisin ngjarjet, faktet dhe zhvillimet më të rëndësishme ekonomike, sociale e politike që karakterizuan botën në fillim të shekullit XX, përfshirë Luftën I Botërore, brenda kufijve kronologjikë të përfshirë në studim;
- të njohin e të përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike në këtë periudhë të përfshira në studim, si: luftë botërore, lëvizje qytetare etj.;
- të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e fillimit të Luftës I Botërore dhe zhvillimeve më kryesore para dhe pas saj;
- të jenë në gjendje të interpretojnë tablo, foto, harta historike etj. për ngjarje, fakte apo dukuri historike;
- të jenë të aftë të argumentojnë pikëpamjet e tyre duke nxjerrë përfundimet përkatëse për ngjarje, figura, fakte apo dukuri historike të studiuara;
- të jenë të aftë që për aspekte të ndryshme të studiuara të periudhës së fillimit të shekullit XX, të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto, tablo, harta historike etj.

KOHA: 2ORË

LINJA 2

TRAKTATET E PAQES DHE PROBLEMET E PAZGJIDHURA TË PASLUFTËS

Tematika

1. Konferenca e Paqes e Parisit dhe krijimi i Lidhjes së Kombeve. Prirjet kryesore të zhvillimeve gjatë viteve 1918-1939.

Objektiva

Nxënësit duhet :

- të rendisin zhvillimet më të rëndësishme ekonomike, sociale e politike që karakterizuan botën në periudhën 1918-1939 të përfshira në studim;
- të përdorin terminologjinë e zhvillimeve historike të kësaj periudhe të përfshirë në studim, si: Lidhja e Kombeve, konferencë paqeje, traktat paqeje etj.;
- të zotërojnë fjalorin e duhur të kësaj periudhe të përfshirë në studim dhe ta përdorin atë.
- të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më kryesore që karakterizuan zhvillimet e shoqërisë njerëzore në vitet 1918-1939;
- të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike të kësaj periudhe;
- të jenë të aftë që për aspekte të ndryshme të periudhave historike të studiuara, të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto, tablo, harta historike etj.

KOHA: 1 ORË

LINJA 3

DIKTATURAT. TOTALITARIZMI KOMUNIST E FASHIST

Tematika

1. Tiparet e regjimeve totalitare. Vendosija e fashizmit në Itali. Ardhja në pushtet e Hitlerit në Gjermani.
2. Përmbysja e regjimit carist në Rusi. Vendosija e plotë e regjimit totalitar komunist.

Objektiva

Nxënësit duhet :

- të rendisin saktë kronologjikisht ngjarjet dhe faktet më të rëndësishme në lidhje me zhvillimet e totalitarizmit komunist e fashist në këto vende në vitet 1918-1939 brenda kufijve kronologjikë;

- të përdorin terminologjinë e këtyre ngjarjeve dhe të dukurive historike, si: diktaturë, totalitarizëm, fashizëm, komunizëm etj.;
- të përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike si: shtet totalitar, diktaturë etj.;
- të përshkruajnë dhe të analizojnë, tiparet më karakteristike të zhvillimit të regjimeve totalitare të vendosura në Itali, Gjermani e Rusi;
- të shpjegojnë shkaqet e vendosjes së këtyre diktaturave dhe pasojat që sollën ato për këto vende dhe popujt e tyre;
- të jenë të aftë të argumentojnë pikëpamjet e tyre duke nxjerrë përfundimet përkatëse për ngjarjet, figurat, faktet që lidhen me këto sisteme qeverisëse diktatoriale.

KOHA: 2 ORË

LINJA 4

DEMOKRACITË PERËNDIMORE NË VITET 1918-1939

Tematika

1. SHBA në vitet '20. Kursi i ri i Ruzveltit.
2. Britania e Madhe dhe Franca në vitet 1918-1939.
3. Kultura dhe arti në vitet 1920-1930.

Objektiva

Nxënësit duhet :

- të përdorin me përpikëri terminologjinë e ngjarjeve dhe të dukurive që karakterizuan zhvillimet e demokracive perëndimore në vitet 1918-1939;
- të përvetësojnë përmbajtjen e koncepteve kryesore historike si: qytetërim perëndimor, demokraci, liberalizëm etj.;
- të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të demokracive perëndimore në vitet 1918-1939;
- të përshkruajnë disa nga arritjet më të rëndësishme shkencore, të artit, kulturës gjatë viteve 1920-1930;
- të analizojnë zhvillimin ekonomik, social e politik të vendeve demokratike gjatë viteve 1918-1939, duke dalluar faktet nga opinionet.

KOHA: 3 ORË

LINJA 5

VENDET E BALLKANIT NË VITET 1918-1939

Tematika

1. Vendet e Ballkanit në vitet 1918-1939.
2. Shqipëria në vitet 1918-1939.

Objektiva

Nxënësit duhet:

- të rendisin kronologjikisht saktë ngjarjet, faktet dhe zhvillimet më të rëndësishme historike, ekonomike, sociale e politike të vendeve të Ballkanit duke përfshirë dhe Shqipërinë në vitet 1918-1939;
- të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të vendeve të Ballkanit dhe Shqipërisë në vitet 1918-1939;
- të vlerësojnë ndryshimet e rëndësishme që karakterizuan zhvillimin ekonomik, shoqëror e politik të këtyre vendeve gjatë viteve 1918-1939;
- të argumentojnë pikëpamjet e tyre duke nxjerrë përfundimet përkatëse për ngjarje, figura, fakte apo dukuri historike të studiuara.

KOHA: 2 ORË

LINJA 6

LUFTA E DYTË BOTËRORE. NDARJA E BOTËS NË DY BLOQE

Tematika

1. Lufta II Botërore. Shkaqet dhe pasojat e saj. Konferenca e Paqes e Parisit.
2. ShBA dhe Bashkimi Sovjetik. Fillimi i Luftës së Ftohtë.
3. Rindërtimi ekonomik. Revolucioni tekniko-shkencor.
4. Hapat drejt integrimit evropian.

Objektiva

Nxënësit duhet:

- të rendisin ngjarjet, faktet dhe zhvillimet më të rëndësishme historike, ekonomike, sociale e politike që çuan në shpërthimin e Luftës II Botërore dhe pasojat e saj;
- të përdorin terminologjinë e ngjarjeve dhe të dukurive historike që karakterizuan këtë periudhë historike, si: luftë e ftohtë, revolucion tekniko-shkencor, integrim evropian etj.;

- të përvetësojnë përmbajtjen ekoncepteve kryesore historike të përfshira në studim, si: luftë e ftohtë, revolucion tekniko-shkencor, integrim evropian etj.;
- të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e shpërthimit të Luftës II Botërore;
- të analizojnë shkaqet dhe pasojat e fillimit të Luftës së Ftohtë, ndarjen e botës në dy blloqe;
- të përshkruajnë arritjet më të rëndësishme shkencore e kulturore gjatë zhvillimit të revolucionit tekniko-shkencor;
- të kuptojnë se për ngjarje, procese e figura të ndryshme historike, ka interpretime të ndryshme;
- të analizojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo figura të kësaj periudhe historike të përfshira në studim;
- të interpretojnë tablo, foto, harta historike etj. për ngjarje, fakte apo dukuri historike.

KOHA: 4 ORË

LINJA 7

KONSOLIDIMI I DEMOKRACISË DHE ZHVILLIMI EKONOMIK I EVROPËS PERËNDIMORE DHE I SHBA-së NË VITET 1945-1990

Tematika

1. Vendet e Evropës perëndimore në vitet 1945-1974.
2. ShBA në vitet 1945-1974.
3. Hapat e tjerë në rrugën e integritit evropian.

Objektiva

Nxënësit duhet:

- të rendisin kronologjikisht saktë ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet më të rëndësishme në lidhje me konsolidimit social dhe politik të demokracisë, si dhe zhvillimin ekonomik të Evropës Perëndimore dhe të ShBA –së, gjatë viteve 1945-1990;
- të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të shoqërisë në vendet e Evropës Perëndimore dhe ShBA-së në vitet 1945-1990;
- të vlerësojnë ndryshimet e rëndësishme që karakterizuan zhvillimin ekonomik, shoqëror e politik të këtyre vendeve, si dhe rolin e figurave të ndryshme historike në këtë drejtim;
- të tregojnë disa nga arritjet më të rëndësishme shkencore, të artit, kulturës dhe teknologjisë

- të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarjet më të rëndësishme që i karakterizuan këto vende në vitet 1945-1990;
- të argumentojnë pikëpamjet e tyre duke nxjerrë përfundimet përkatëse për ngjarjet, figurat, faktet apo dukuritë historike të këtyre vendeve;
- të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni.

KOHA: 3 ORË

LINJA 8

BLOKU KOMUNIST. DËSHTIMI I KOMUNIZMIT 1945-1990

Tematika

1. Bashkimi Sovjetik gjatë viteve 1945-1990.
2. Evropa Lindore nën sundimin komunist. Revolucionet e vitit 1989 në Evropën Lindore

Objektiva

Nxënësit duhet:

- të rendisin kronologjikisht saktë ngjarjet, faktet dhe zhvillimet më të rëndësishme historike, ekonomike, sociale e politike të bllokut komunist brenda kufijve kronologjikë;
- të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit ekonomik, social e politik të vendeve të Evropës Lindore gjatë viteve 1945-1990;
- të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve historike, të situatave dhe ndryshimeve në revolucionet e vitit 1989 në Evropën Lindore;
- të vlerësojnë në mënyrë kritike interpretimet për ngjarjet që çuan në përmbysjen e komunizmit në ish-BS dhe vendet e tjera të Evropës Lindore;
- të jenë të hapur për të diskutuar në mënyrë të argumentuar ndaj pikëpamjeve të ndryshme për zhvillimin historik të këtyre vendeve, duke dalluar faktet nga opinionet;
- të jenë të aftë që për aspekte të ndryshme të periudhës historike të studiuar, të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto etj.

KOHA: 2 ORË

LINJA 9

VENDET E BALLKANIT NË VITET 1945-1990

Tematika

1. Vendet e Ballkanit në vitet 1945-1990.
2. Shqipëria në vitet 1945-1990.

Objektiva

Nxënësit duhet:

- të krijojnë linjën e kohës me ngjarjet dhe zhvillimet më të rëndësishme historike, ekonomike, sociale e politike të vendeve të Ballkanit në vitet 1945-1990;
- të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të shoqërive ballkanike në vitet 1945-1990;
- të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve historike, të situatave dhe ndryshimeve të ndodhura në këto vende në vitet 1945-1990;
- të jenë të hapur për të diskutuar në mënyrë të argumentuar ndaj pikëpamjeve të ndryshme për zhvillimin historik të shoqërive të këtyre vendeve, duke dalluar faktet nga opinionet;
- të përdorin në mënyrë të pavarur burime të ndryshme informacioni, si: dokumente historike, foto, tablo, harta historike etj.

KOHA: 2 ORË

LINJA 10

SHKENCA, KULTURA, ARTI DHE PROBLEMET E BOTËS SË SOTME

Tematika

1. Zhvillimet në shkencë dhe teknologji. Kultura arti dhe feja në botën e sotme.
2. Ndërvarësia ekonomike botërore.

Objektiva

Nxënësit duhet:

- të rendisin ngjarjet, faktet, figurat dhe zhvillimet më të rëndësishme në fushat e artit, të shkencës, kulturës, si dhe problemet më të rëndësishme të botës së sotme;
- të përdorin me përpikëri terminologjinë e ngjarjeve dhe të zhvillimeve më të rëndësishme si: ndërvarësi ekonomike botërore, globalizim etj.;
- të përshkruajnë dhe të analizojnë tiparet më karakteristike të zhvillimit të artit, shkencës, kulturës, si dhe problemet më të rëndësishme të botës së sotme;
- të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e problemeve të krijuara si rrjedhojë e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

- të tregojnë disa nga arritjet më të rëndësishme shkencore, të artit, kulturës dhe teknologjisë të kohës së sotme;
- të jenë të aftë të kuptojnë se për procese e zhvillime të ndryshme në fushat e lartpërmendura, si dhe për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që karakterizojnë shoqërinë njerëzore, ka interpretime të ndryshme.

KOHA: 2 ORË

KLASA IX
NJOHURI MBI HISTORINË E
POPULLIT SHQIPTAR
30 javë x 1 orë = 30 orë

OBJEKTIVAT DHE TEMATIKA SIPAS LINJAVE

NR	LINJAT	TEMATIKA	OBJEKTIVA	SASIA E ORËVE
1.	PARAARDHËSIT E SHQIPTARËVE	- Banorët e hershëm të vendit tonë. Ilirët.	Nxënësit duhet: <ul style="list-style-type: none"> - të tregojnë se kur kanë filluar të banohen trojet shqiptaret; - të përshkruajnë mënyrën e jetesës të të parëve tanë; - të tregojnë qendrat e banuara prehistorike të vendit tonë; - të përcaktojnë vendndodhjen e ilirëve në Gadishullin e Ballkanit; - të flasin për disa nga virtytet e ilirëve. 	1 orë
2.	SHTETET ILIRE	- Shteti i Epirit dhe Mbretëria Dardane.	Nxënësit duhet: <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojnë kufijtë e shtetit të 	1 orë

		<ul style="list-style-type: none"> - Arti dhe kultura. Roma dhe Iliria. 	<p>Epirit dhe mënyrën e qeverisjes në Epir dhe rolin e Pirros në këtë shtet;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojnë se ku shtrihej Mbretëria Dardane dhe të dallojnë emrat e disa fiseve e mbretërive dardane; - të përshkruajnë karakteristikat e artit parahistorik dhe ndryshimin që pësoi ai në periudhën qytetare ilire; - të rendisin disa të dhëna për kulturën ilire, gjuhën dhe paganizmin; - të përshkruajnë shkaqet e luftërave ilire –romake dhe ndikimin e tyre në Iliri. 	
3.	SHQIPËRIA MESJETARE SHEK V – XIV	<ul style="list-style-type: none"> - Shqipëria në shekujt e parë të mesjetës. - Principata e Arbrit. Principatat shqiptare gjatë shek. XIV. - Kultura, arti dhe shoqëria shqiptare në mesjetë. 	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përcaktojnë vendin që zinin trojet shqiptare në Perandorinë Bizantine; - të rendisin pasojat dyndjeve sllave në trojet e banuara nga shqiptarët; - të argumentojnë vazhdimësinë ilire-shqiptare; - të përshkruajnë ndryshimet kryesore që solli zhvillimi i marrëdhënieve feudale; - të përshkruajnë vendin dhe rolin e Principatës së Arbrit; - të përmendin dhe të përshkruajnë disa nga aspektet të zhvillimit të arsimit, letërsisë dhe të fesë në mesjetë. 	2 orë
4.	EPOKA E GJERGJ KASTRIOTIT –	<ul style="list-style-type: none"> - Ardhja e osmanëve në Ballkan; Lidhja Shqiptare e Lezhës 	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajnë gjendjen e territoreve të Ballkanit në prag të pushtimit 	3 orë

	SKËNDERBEUT	<p>dhe fitoret e saj të para nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrëdhëniet e Skënderbeut në Evropë. Rëndësia e epokës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. 	<p>osman;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajnë momentet kryesore të jetës dhe veprimtarisë së Gjergj Kastriot Skënderbeut; - të shpjegojnë arsyet e thirrjes së Kuvendit të Lezhës; - të listojnë vendimet e Kuvendit të Lezhës duke evidentuar rëndësinë e tyre; - të rendisin betejat kryesore nën drejtimin e Skënderbeut; - të përshkruajnë tiparet e shtetit nën drejtimin e Skënderbeut; - të vlerësojnë aftësinë e Skënderbeut në formimin e shtetit; - të përshkruajnë jetën e shoqërisë arbërore gjatë periudhës së Skënderbeut; - të evidentojnë rëndësinë historike që pati periudha e Skënderbeut. 	
5.	SHQIPËRIA GJATË SUNDIMIT OSMAN (SHEK. XVI- XIX)	<ul style="list-style-type: none"> - Ndryshimet në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare në shek. XVI-XVIII. Bashkëjetesa fetare. - Pashallëku i Shkodrës dhe i Janinës. Rëndësia e tyre. 	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojnë sistemin e ri të timarit dhe pasojat e tij; - të tregojnë rëndësinë që pati kryengritja e vitit 1537 dhe cili qe qëllimi kryesor i kuvendeve shqiptare dhe atyre ballkanike; - të përshkruajnë zhvillimin e artit, e kulturës, e arkitekturës, e arsimit dhe të fesë gjatë kësaj periudhe; - të shpjegojnë se në ç`rrethana u krijua 	3 orë

			<p>çifligu dhe cilat qenë tiparet e tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të bëjnë dallimet e zhvillimit ekonomik të qyteteve shqiptare në shek. XVII-XVIII dhe cilat qenë përpjekjet për ruajtjen e gjuhës shqipe; - të shpjegojnë përpjekjet shtetformuese, si u krijua Pashallëku i Shkodrës dhe ai i Janinës dhe cilat qenë shkaqet e rënies dhe rëndësia e tyre. 	
6.	<p>RILINDJA KOMBËTARE SHQIPTARE (vitet 30 deri 1908)</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Rilindja kombëtare shqiptare. Përmbajtja, etapat dhe karakteristikat e tyre. - Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Përpjekjet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për formimin e shtetit shqiptar. - Ruajtja e tërësisë tokësore të Shqipërisë Lidhja e Pejës. - Lëvizja kombëtare shqiptare në vitet 1900-1908. Përhapja e shkollave dhe letrave shqiptare. 	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përkufizojnë se ç`kuptojnë me Rilindje Kombëtare Shqiptare dhe të njohin disa nga rilindësit e parë; - të argumentojnë pse ishte e nevojshme thirrja e një kuvendi të përgjithshëm shqiptar dhe qëndrimi që mbajti Porta e Lartë; - të rendisin vendimet e Kongresit të Berlinit dhe të përshkruajnë ndikimin e tyre në Shqipëri; - të rendisin çështjet kryesore të platformës së Lidhjes së Prizrenit për pavarësi dhe të shpjegojnë acarimin e marrëdhënieve me Stambollin; - të shpjegojnë pse u formua qeveria e përkohshme e Prizrenit dhe ç`masa mori ajo. Ku qëndron rëndësia historike?; - të tregojnë se në ç`rrethana u parashtruan kërkesat e reja për autonomi pas rënies së Lidhjes së 	3 orë

			<p>Prizrenit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të argumentojnë rëndësinë që pati Lidhja e Pejës; - të tregojnë programet dhe veprimtarinë e komiteteve të fshehta dhe çetave patriotike në vitet 1901-1908; - të shpjegojnë ndikimin që pati Lidhja e Prizrenit në lëvizjen kulturore veçanërisht për arsimin kombëtar; - të përmendin shoqëritë kryesore në diasporën shqiptare dhe të përshkruajnë rolin e tyre për lëvizjen kombëtare; - të përshkruajnë rrethanat e çeljes së mësonjëtores shqipe të Korçës dhe ç`karakter kishte ajo. 	
7.	<p>SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË 1908-1912</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kryengritja e përgjithshme e vitit 1912. - Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë. 	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojnë pse u mbajt Kongresi i Manastirit dhe i Elbasanit dhe të rendisin vendimet kryesore të tyre; - të argumentojnë rëndësinë e Kongresit të Dibrës; - të shpjegojnë shkaqet e shpërthimit të kryengritjes së vitit 1910 dhe 1911 dhe rëndësia e tyre; - të përshkruajnë se si u përgatit kryengritja e vitit 1911 dhe të argumentojnë pse ajo mori karakter kombëtar. Memorandumi i Grecës; - të nxjerrin në pah karakterin e Luftës së 	2 orë

			<p>parë Ballkanike dhe cili qe qëndrimi i shqiptarëve ndaj saj;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojnë si u kalua nga platforma autonomiste në atë të pavarësisë dhe ku qëndron rëndësia e shpalljes së Pavarësisë. 	
8.	<p>SHQIPËRIA DHE VISET E TJERA SHQIPTARE JASHTË KUFIJVE NË VITET 1912-1924</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Qeveria Kombëtare e Vlorës e kryesuar nga Ismail Qemali. - Lufta për çlirimin e bashkimit kombëtar në viset e pushtuara nga Serbia dhe Mali i Zi (1912-1915). - Shqipëria gjatë regjimit të Vidit. Përpyekjet për shkatërrimin e shtetit shqiptar. - Shqipëria, Kosova dhe viset e tjera shqiptare gjatë Luftës I Botërore. - Kongresi i Lushnjës. Lufta e Vlorës. - Shqipëria në vitet 	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajnë në ç'rrethana u formua qeveria e I. Qemalit, qëndrimin që mbajti ajo ndaj Luftës Ballkanike dhe masat e saj në fushën arsimore dhe ekonomike; - të flasin për vendimin e Konferencës së Ambasadorëve në Londër për kufijtë dhe njohjen e pavarësisë; - të tregojnë shkaqet e kryengritjet shqiptare në vitin 1913 e më pas; - të përshkruajnë qëndrimin që mbajti qeveria e Vidit pas caktimit të kufijve të Shqipërisë, veçanërisht me lëvizjen vorio-epiriote; - të flasin për Shqipërisë e viset e tjera shqiptare gjatë Luftës I Botërore dhe të nxjerrin në pah detyrat e Lëvizjes Kombëtare shqiptare gjatë kësaj lufte; - të argumentojmë pse ishte e domosdoshme thirrja e Kongresit Kombëtar të Lushnjës dhe të njohim vendimet e tij; - të nxjerrim në pah arsyet e fillimit të Luftës së Vlorës dhe rëndësinë që pati 	3 orë

		<p>1920-1923.</p> <p>- Lëvizja e Qershorit 1924.</p>	<p>ajo për sovranitetin e Shqipërisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të dallojnë se me ndihmën e kujt u ripushtua Kosova dhe të përshkruajnë rolin që luajti “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”; - të flasin për situatën e pas Luftës I Botërore dhe përpjekjet e shqiptarëve për forcimin e pozitave të shtetit shqiptar në vitet 1920-1923; - të shpjegojnë shkaqet e Lëvizjes së Qershorit 1924, programin e Qeverisë së F. Nolit dhe rëndësinë që pati ai. 	
9.	SHQIPËRIA NË VITET 1925-1939.	<ul style="list-style-type: none"> - Republika shqiptare 1925-1928. Mbretëria shqiptare 1928-1939. - Lëvizjet me karakter politik, shoqëror e kulturor. 1925-1939. 	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të flasin për shpalljen e Republikës dhe Statutin themeltar; - të dallojnë hapat për zhvillimin kapitalist të vendit; - të rendisin kur u shpall Mbretëria, kompetencat e mbretit dhe të parlamentit si dhe masat që u morën për vendosjen e shtetit ligjor; - të flasin për marrëveshjet italo-shqiptare dhe të shpjegojnë pasojat e tyre; - të përshkruajnë nivelin e jetës qytetare dhe arritjet në fushën e arsimit, letërsisë dhe arteve. 	2 orë
10.	GJENDJA E SHQIPTARËVE ETNIKE NË JUGOSLLAVI	<ul style="list-style-type: none"> - Shpronësimi dhe shpërngulja me dhunë e shqiptarëve në Jugosllavi. 	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojnë qëllimin e reformës agrare për kolonizimin e Kosovës dhe shpronësimin e shqiptarëve; 	1 orë

	DHE GREQII 1925-1940	- Shpronësimi dhe shpërngulja me dhunë e shqiptarëve, çamëve në Greqi në vitet 1924-1940.	- të përcaktojnë synimet e platformës së shpërnguljes së shqiptarëve dhe drejtimin e shpërnguljes së tyre; - të analizojnë faktorët që ndikuan në dështimin e platformës së shpërnguljes dhe shkombëtarizimit; - të përshkruajnë format karakteristike të qëndresës së shqiptarëve dhe të shpjegojnë rezultatet e kësaj qëndrese.	
11.	SHQIPTARËT GJATË LUFTËS II BOTËRORE	– Sulmi fashist italian i 7 Prillit, administrata shtetërore dhe rezistenca gjatë pushtimit italian në vitet 1939-1943. – Pushtimi gjerman dhe ngritja e aparatit administrativ. – Platforma politike e PKSH, Ballit Kombëtar, Legalitetit, Konferencës së Pezës dhe Konferencës së Mukjes gjatë Luftës Antifashiste. – Kongresi i Përmetit dhe çlirimi i plotë i Shqipërisë. – Kosova gjatë Luftës II Botërore.	Nxënësit duhet: - të rendisin masat që mori Italia për pushtimin e Shqipërisë; - të përshkruajnë qëndresën e shqiptarëve; - të identifikojnë programet politike që u formuan gjatë Luftës së Dytë Botërore; - të vlerësojnë qëndresën e armatosur të shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore; - të vlerësojnë Konferencën e Pezës dhe të Mukjes, si përpjekje për krijimin e frontit antifashist; - të përcaktojnë shkaqet e dështimit të Konferencës së Mukjes; - të shpjegojnë tiparet e reja që mori lufta pas Konferencës së Mukjes; - të dallojnë tri fazat që kaloi Lufta e Dytë Botërore në Shqipëri: rezistencën 1939-1942, luftën e armatosur 1942-1943, tiparet e reja që mori lufta gjatë viteve 1943-1944.	2 orë

		– Çamëria gjatë Luftës II Botërore.		
12.	SHQIPËRIA GJATË REGJIMIT KOMUNIST	-Vendosja e regjimit komunist në Shqipëri 1944-1948. -Regjimi komunist në Shqipëri 1948- 1978 (tipare të jetës politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore gjatë viteve 1948 – 1978). -Marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë 1945-1990. -Vetizolimi i shtetit komunist gjatë viteve 1978-1990.	Nxënësit duhet: - të përshkruajnë masat që u morën për vendosjen e regjimit komunist dhe formën e regjimit që u vendos; - të analizojnë masat kryesore të qeverisë kundër pronës private dhe drejtimit themelore të zhvillimit të arsimit e kulturës; - të përshkruajnë qëndresën e forcave demokratike dhe antikomuniste ndaj regjimit; - të shpjegojnë orientimin lindor dhe faktorët që përcaktuan këtë orientim; - të shpjegojnë zbatimin e sistemit stalinist për ngritjen e industrisë dhe kolektivizimin e fshatit; - të analizojnë marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe Bashkimin Sovjetik dhe motivet e prishjes së këtyre marrëdhënieve; - të rendisin dukuritë më tipike të politizimit dhe idealizimit të skajshëm të jetës së vendit; - të shpjegojnë keqësimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me botën e jashtme që e vetizoloi atë më shumë.	3 orë
13.	RENIA E REGJIMIT KOMUNIST	- Kriza e regjimit komunist. - Lëvizja demokratike,	Nxënësit duhet: - të identifikojnë disa nga tiparet e krizës ekonomike, kryesisht në bujqësi dhe në	2 orë

		<p>pluralizmi politik dhe krijimi i partive politike.</p> <p>- Shqipëria nga tranzicioni në integrimin euroatlantik 1990 – sot.</p>	<p>industri;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajnë disa nga momentet kryesore të shprehjes së pakënaqësisë popullore kundër diktaturës komuniste; - të shpjegojnë rrethanat e krijimit të partisë politike; - të vlerësojnë rolin që pati për Shqipërinë, anëtarësimi i saj në NATO; - të shpjegojnë kontributin që jep sot shteti shqiptar në kuadrin e Aleancës së Atlantikut; - të vlerësojnë rolin e shtetit shqiptar në forcimin e marrëdhënieve ndërshtetërore në rajonin e Ballkanit; - të evidentojnë hapat e ndërmarrë nga qeveria shqiptare drejt integritetit të plotë të saj në BE. 	
14.	<p>SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE POLITIKË 1945 – SOT</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kosova në vitet 1945-1948 - Shqiptarët në Kosovë në vitin 1949-1974 - Shqiptarët në Kosovë në vitin 1974- 2000 - Diaspora shqiptare 1944-1990 	<p>Nxënësit duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përshkruajnë gjendjen ekonomike, politike dhe qëndresën e shqiptarëve në Jugosllavi 1945-1968; - të shpjegojnë rëndësinë e Kushtetutës së vitit 1974 për Kosovën; - të përshkruajnë politikën e rivendosjes së autoritetit serb në Kosovë, duke evidentuar dhunën që ai ushtroi ndaj shtetasve kosovarë; - të shpjegojnë procesin e luftës së Kosovës për pavarësi, duke evidentuar rolin që patën ndërkombëtarët në këtë proces; 	2 orë

			<ul style="list-style-type: none">- të rendisin faktorët që çuan në pavarësinë e Kosovës;- të vlerësojnë rëndësinë që pati shpallja e Pavarësisë për Kosovën;- të përshkruajnë rolin e shoqërisë shqiptare, të shtypit, të medias në mbrojtjen e të drejtës çame.	
--	--	--	---	--